

CILËSIA

KA TRADING sh.p.k garanton klientët dhe autoritetet, që ajo është e angazhuar të sigurojë nivelet më të larta të cilësisë dhe sigurisë nëpërmjet zbatimit të një sistemi efektiv të kontrollit të cilësisë dhe të proceseve, përcaktimit të kriterëve të performancës dhe kryerjen e testeve të vazhdueshme, në mënyrë që të mbështesë aktivitetin e **prodhimit të pelenave të fëmijëve, pelenave të të rriturve dhe shtrojeve sanitare.**

KA TRADING sh.p.k do të ofrojë pelena për fëmijë, pelena për të rritur dhe shtroje sanitare, që përmbushin dhe tejkalojnë kërkesat e klientëve dhe ato të autoriteteve përkatëse duke zbatuar të gjitha procedurat dhe standardet ISO 9001:2008 dhe ISO 13485:2003.

KA TRADING sh.p.k ka përcaktuar dhe rishikon objektivat e Cilësisë në mënyrë të vazhdueshme duke i konsideruar ato si udhërrëfyese në aktivitetin e saj.

KA TRADING sh.p.k do të përpiqet vazhdimisht të përmirësojmë cilësinë dhe sigurinë nëpërmjet të trajnimeve, komunikimit të informacionit, bashkëpunimit me klientët, punonjësit, furnizuesit, autoritetet dhe pjesëmarrjes në programet e përmirësimit të vazhdueshëm.

KONTROLLI DHE SIGURIMI I CILËSISË

KA TRADING sh.p.k ka zhvilluar, dokumentuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për të siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjore, si edhe që produktet e saj të përmbushin kërkesat e përcaktuara duke zbatuar kërkesat e standardeve ISO 9001:2008 dhe ISO 13485:2003 dhe jo vetëm.

KA TRADING sh.p.k projektton, zhvillon dhe teston produktet e saj në mënyrë sistematike dhe të planifikuar duke u mbështetur në metodologji testuese që sigurojnë besueshmëri dhe saktësi.

PRAKTIKAT E MIRA TË PRODHIMIT

KA TRADING sh.p.k zbaton Praktikën e Mira të Prodhimit gjatë gjithë procesit të prodhimit. Kompania është e certifikuar sipas standardeve ISO 9001:2008 dhe ISO 13485:2003 dhe vazhdon të investojë për të patur pajisjet dhe teknologjinë më të fundit, që të sigurojë vazhdueshmërinë prodhimit të pelenave për fëmijë, pelenave për të rritur dhe shtrojeve sanitare.

KA TRADING sh.p.k renditet e para në prodhimin e pelenave për fëmijë, pelenave për të rritur dhe shtrojeve sanitare duke monitoruar çdo fazë të projektimit dhe zhvillimit të produktit dhe duke zbatuar metoda kontrolli të cilësisë në çdo stad të procesit të prodhimit.

OBJEKTIVAT E CILËSISË

Kompania KA TRADING sh.p.k ka vendosur:

- Të punësojë, zhvillojë dhe mbajë punonjës shumë të kualifikuar, me aftësi profesionale të larta dhe të aftë për të siguruar drejtimin e kompanisë duke mirëmbajtur dhe përmirësuar proceset e biznesit dhe të cilësisë.
- Të zbatojë masa parandaluese për të përmirësuar vazhdimisht cilësinë dhe sigurinë e pelenave të fëmijëve, pelenave të të rriturve dhe shtrojeve sanitare, si edhe eficientësinë e proceseve.

- Të respektojë të gjitha kërkesat ligjore që lidhen me sigurinë e produktit.
- Të mirëmbajë dhe përmirësojë marrëdhëniet me furnitorët.
- Të zbatojë dhe mirëmbajë Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë në të gjitha proceset me qëllimin përmbushjen e kërkesave të klientëve.
- Të krijojë dhe mirëmbajë një mjedis pune të sigurtë për shëndetin e punonjësve dhe sigurinë e produktit.

KA TRADING sh.p.k është e angazhuar të zbatojë Politikën e Cilësisë.